



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

Shtojca 1-Raporti për Thjeshtësimin e Lejeve dhe Licencave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit¹

Mars 2023

¹ Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 138-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/138 të datës 12.04.2023.

Lista e shkurtesave

DAL – Departamenti për Arsim të Lartë

DAPP – Divizioni për Arsim Privat Parauniversitar

DZHPM – Divizioni për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve

IFC - International Fund Corporation

LPPA - Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative

LSSL – Ligji Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave

MASHTI – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

PVK – Pikat e Vetme të Kontaktit

ZL - Zyra Ligjore

ZKM - Zyra e Kryeministrit

Përmbledhje Ekzekutive

Në Republikën e Kosovës, ekziston një numër i madh i lejeve dhe licencave që në tërësi janë rreth 480. Të njëjtat leje dhe licenca, përtej qëllimit rregullator në funksion të rendit, ligjit dhe të shërbimeve më të mira publike, në raste të caktuara paraqesin probleme nga më të ndryshmet si për bizneset ashtu edhe për qytetarët. Kjo duke pasur parasysh faktorë që lidhen nga dizajni konceptual apo modeli i zgjedhur rregullator deri te problemet praktike në zbatim.

Baza qendrore ligjore në rendin juridik të Kosovës ofrohet nga Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave (LSLL). Ky ligj ka për qëllim vendosjen e rregullave dhe të parimeve për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës. Në praktikë, ky ligj nuk është zbatuar në raste të shumta, siç dëshmohet nga analiza e shpërfaqur në këtë raport narrativ. Për më tepër, me qëllim të harmonizimit të ligjeve të veçanta që përcaktojnë bazën ligjore të lejeve dhe licencave edhe me procedurën e përgjithshme administrative, qëllim tjetër i kësaj analize ka qenë edhe përafrimi i procedurave për paisjen me leje dhe licenca me procedurën administrative të përcaktuar më Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Qëllimi themelor i këtij raporti është përcaktimi dhe paraqitja e gjendjes së lejimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Këto përcaktime janë produkt i një analize bërë legjislacionit përkatës dhe praktikës së ndërlidhur me të, qëllimi i së cilës është të ofrojë rekomandime të përgjithshme dhe të veçanta, të cilat kanë për objektiv zvogëlimin e barrës së panevojshme të disa lejeve dhe licencave, si dhe thjeshtëzimin e procedurës për marrjen e tyre nga bizneset dhe qytetarët. Në proces të analizës dhe si rezultat i saj janë hetuar disa mangësi të vërejtshme, duke përfshirë numrin e madh të licencave të cilat konsiderohen të panevojshme dhe nuk janë aplikuar asnjëherë; pastaj, rastet kur emërtimet e lejimeve nuk janë në përputhshmëri me përkufizimet e LSLL sa i përket llojit dhe kritereve të tyre, nuk zbatohen instrumentet e zvogëlimit të barrierave siç janë parimi sipas detyrës zyrtare të zhvillimit të procedurës dhe mbledhjes së dokumenteve dhe fakteve, zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike dhe përmes Pikave të Vetme të Kontaktit (PKV), pagesa dhe taksa administrative të cilat parashihen me udhëzime administrative dhe të cilat nuk aplikohen meqenëse nuk ka arsyeshmëri pas tyre, etj.

Për të adresuar këto mangësi dhe shmangur ato në të ardhmen, rekomandohet ndërmarrja e një serie veprimesh konkrete, në mënyrë të veçantë: (a) niveli i lejimit (njoftimi, regjistrimi, leja dhe licenca profesionale) duhet të përcaktohet sipas nivelit të rrezikut dhe rregullave të përcaktuara në LSLL; (b) lejitimet e panevojshme të cilat nuk janë aplikuar asnjëherë të mos jenë pjesë e akteve nënligjore si kërkesa të njëpasnjëshme; (c) të zbatohen instrumentet e thjeshtësimit administrativ, përfshirë parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare dhe mbledhjes së dokumenteve dhe fakteve, zhvillimin e procedurës në mënyrë elektronike dhe përmes Pikave të Vetme të Kontaktit, reduktimin dhe thjeshtësimin e informatave të detyrueshme; (d) aplikimi i pagasave dhe taksave administrative të bëhet vetëm si përjashtim dhe kufijtë e saj, kurdo që është e justifikueshme, të përcaktohen me ligj mbështetur në rregullat e LSLL dhe LPPA.

Hyrje

Në vijim të procesit të reformës për thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit (ZL-ZKM), me mbështetje të *Korporata Ndërkombëtare Financiare* (International Finance Corporation -IFC)/Grupit Bankës Botërore, ka filluar analizën e inventarizimit dhe thjeshtëzimit të lejeve dhe licencave për MASHTI dhe harmonizimit të të njëjtave me LSSL. Një total prej 11 licencash janë analizuar në këtë sektor.

Raporti ka për qëllim të identifikojë, analizojë dhe ofrojë rekomandime për thjeshtimin e lejeve dhe licencave të administruara nga MASHTI, përkatësisht një (1) procedurë që bie në fushëveprimtarinë e Departamentit të Arsimit të Lartë (DAL), gjashtë (6) procedura që bien në fushëveprimtarinë e Departamentit për Arsim Parauniversitar, Divizionit për Zhvillimin profesional të mësimdhënësve (DZHPM), katër (4) procedura që hyjnë në fushëveprimtarinë e Departamentit për Arsim Parauniversitar, Divizioni për Arsim Privat Parauniversitar (DAPP).

Procesi i inventarizimit dhe analizës së lejeve dhe licencave, i kompletuar gjatë periudhës Gusht – Nëntor 2022, është bërë në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Gjatë procesit të analizimit, vëmendje e veçantë i është kushtuar bazës ligjore të të gjitha lejeve dhe licencave përkatëse që lëshohen në kuadër të MASHTI, procedurës që ndiqet nga ana e departamenteve përkatëse, dokumenteve që kërkohen në aspektin e nevojshmërisë së tyre, si dhe formës në të cilën kërkohet të dorëzohen. Më tej, është analizuar edhe fluksi i kërkesave për lejet dhe licencat përkatëse dhe fluksi i lejimeve të dhëna nga MASHTI. Për më tepër, gjatë analizës, është vlerësuar nevoja e ekzistimit të të njëjtave, funksioni që e kryejnë, si dhe mundësia e thjeshtëzimit të tyre në aspektin e dokumentacionit dhe pagesave të ndryshme. Në të njëjtën kohë, në procesin e thjeshtëzimit, është analizuar edhe mundësia e bashkimit të disa prej tyre dhe heqja e tyre nga procedurat ekzistuese brenda Ministrisë.

Gjatë procesit të hulumtimit dhe analizës, janë konsultuar edhe personat juridik/bizneset dhe kompanitë që ushtrojnë funksionet përkatëse për të cilat kërkohen lejimet e tilla. Gjatë këtyre takimeve, është diskutuar për barrën administrative që këto procedura krijojnë për këto biznese, si dhe nevojën e tyre në kuadër të rrezikut që veprimtaria përkatëse bartë.

Ky raport paraqet analizën narrative me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet e përgjithshme dhe analizën me të gjeturat dhe rekomandimet e veçanta për secilën leje dhe licencë në formë tabelore në Shtojcën I, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Analiza dhe të gjeturat

Në këtë pjesë paraqiten në përgjithësi llojet e lejimeve, autoritetet përgjegjëse, si analiza e legjislacionit dhe të gjeturat kryesore.

Nga ana e MASHTI jepen 11 lloje të lejimeve, siç janë identifikuar në raport, e të cilat janë të ndryshme si për nga niveli i rrezikut ashtu edhe për nga emërtimi i cili nuk është në pajtim me LSSL. Në tabelën e mëposhtme do të prezantohet të dhënat për secilin lloj lejimi dhe autoritetin përgjegjës.

Tabela Nr. 1.

Lejet dhe licencat në MASHTI

Departamentit për Arsim Parauniversitar		
<i>Kodi/Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Lloji i lejimit sipas LSSL</i>
DZHPM	Licenca e përkohshme për mësimdhënës fillestar Licenca për mësimdhënës meritior Licenca për mësimdhënës të avancuar Licenca për mësimdhënës të karrierës Licenca për mësimdhënës të merituar Licenca për bashkëpunëtor profesional	Licencë
DAPP1-A	Licenca e institucioneve private parashkollore	Leje
DAPP 2-A	Licenca e institucioneve private parauniversitare	Leje
DAPP 3-A	Licencimi i institucioneve private aftësuese	Leje
Departamenti për Arsim të Lartë		
DAL1-A	Licenca e bartësve privat të arsimit të lartë	Leje

Analiza ligjore

Në këtë pjesë prezantohet analiza e legjislacionit kryesor që rregullon lejitimet në MASHTI. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave (në vijim LSSL) është ligji horizontal që rregullon parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin

publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës². Ligj tjetër horizontal që rregullon në përgjithësi ushtrimin e autoritetit publik ku më së shpeshti vie në shprehje tek lejet është Ligji për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), qëllimi i të cilit është të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave³. Më poshtë do të analizojmë disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parashikuara në këto ligje dhe rregullat e veçanta që ekzistojnë në legjislacionin që rregullon lejet në sistemin ministror të shëndetësisë.

Parimi i ligjshmërisë, është kërkesë dhe obligim ligjor i përcaktuar në LSSL por edhe në LPPA si dhe në Kushtetutën e Kosovës ku sipas këtij parimi lejet dhe licencat duhet të caktohen vetëm me ligj. Lejet dhe licencat që lëshohen nga MASHTI mbështeten në Ligjin Nr. 04/L-032 mbi Arsimin Parauniversitar, Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë dhe Ligjin Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor. Përkundër praktikave të hasura deri më tani në disa prej ministrive tjera, të gjitha lejet dhe licencat që lëshohen nga MASHTI kanë bazë ligjore në këto ligje. Mirëpo, edhe pse të njëjtat janë të bazuara në ligjet në fuqi, ka shumë mundësi intervenimi të cilat do të lehtësonin barrën administrative në përgjithësi.

Fenomeni i rilicencimit, ekziston pothuajse në të gjitha llojet e lejeve që lëshohen nga MASHTI, ku pas kalimit të afatit kohor të caktuar, personat detyrohen të pajisen rishtazi me të njëjtat për të cilat procedurat janë pothuajse të njëjtat. Justifikimi për procesin e rilicencimit ekziston për nevojën e një kontrolli që duhet t'i bëhet lejes ose licencës dhe një tarifë që duhet të paguhet (për tarifën do të flitet veçmas). Procesi i rilicencimit përveç që nuk parashikohet me LSSL i njëjti ka shkaktuar mjaft ngarkesë si për personat ashtu edhe për vet organet publike që janë të autorizuar me këtë proces. Me qëllim të harmonizimit me LSSL, rekomandimi konkret do të duhej të ishte heqja e procedurës së ri-licencimit si proces ligjor dhe fuqizimi i mekanizmave inspektues për verifikimin e vazhdueshëm të personave fizik dhe juridik nëse të njëjtit në vazhdimësi plotësojnë kriteret e kërkuara për të vazhduar ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, mirëpo për shkak të mungesës së inspektorëve dhe institucioneve në numër të madh që licencohen, rekomandimi është që të zgjatet afati i licencës. Shembuj konkret ku është rekomanduar zgjatja e afatit të vlefshmërisë së licencës janë: Licenca e institucioneve private parashkollore dhe Licenca e bartësve privat të arsimit të lartë.

Pagesat dhe taksat, aplikohen për të gjitha llojet e lejeve dhe licencave që administrohen nga MASHTI edhe pse sipas LSSL e njëjta mund të lejohet vetëm kur autoriteti kompetent mund të ngarkojë për një lejim nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejin. Rregull të ngjashëm ka edhe LPPA i cili për zhvillimin e procedurës vetëm përjashtimisht parasheh pagesën dhe atë vetëm nëse parashihet me ligj të veçantë por edhe në këtë rast e njëjta nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës administrative⁴. Tek lejet dhe licencat që lëshohen në kuadër të MASHTI, shumat të caktuara janë paraparë të paguhet me rastin e parashtrimit të kërkesës për licencim përmes udhëzimeve konkrete administrative ose vendime të nxjerrura nga ministri përkatës. E njëjta ndodh edhe me rastin e rilicencimit. Njëri nga këto raste është tek Licencimi i institucioneve të arsimit të lartë privat ku në nenin 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 25/2012 Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë është përcaktuar që MASHTI cakton një shumë të arsyeshme të taksave të licencimit i cili rregullohet me një vendim nga ana e ministrit. Mirëpo ajo çfarë është vërejtur gjatë analizës është që disa nga këto pagesa nuk kërkojnë. Në

² Ligji NR. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave, neni 1.

³ Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 1.

⁴ Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 12.

anën tjetër, pothuajse të gjitha këto kostot që aplikohen, përveç që nuk përcaktohen me ligj, të njëjtat caktohen kryesisht me akte nënligjore dhe nuk marrin parasysh parimet e cekura më lartë dhe të cilat janë të papërbalueshme⁵. Një tjetër problematikë është edhe tek mënyra e pagesës ku pagesat duhet të bëhen vetëm në bankë ose në postë pas marrjes së formularit në këto institucione dhe e njëjta duhet të dëshmohet me dëftesën e pagesës. Mënyra e pagesës përmes e-banking ose kartelës bankare ende nuk aplikohet në këto raste.

Aplikimi dhe zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike, është një tjetër aspekt i cili ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat e personave për t'u pajisur me një leje apo licencë. Aplikimi elektronik është kërkesë ligjore e LSSL ndërsa zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike e LPPA. Në rastin konkret të gjitha aplikimet duhet kryer fizikisht. Në të gjitha rastet pengesë kryesore është mos ekzistimi i një sistemi elektronik të të dhënave të cilët do të lehtësonin mënyrën e aplikimit, pranimin e informatave, verifikimin e tyre dhe lëshimin e lejimeve përkatëse.

Parimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, nënkupton që organi publik është i obliguar që sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative në rastin konkret të një leje ose licence⁶. Ky parim plotësohet me rregullin tjetër sipas të cilit dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre⁷. Nga analiza e bërë në MASHTI ky parim nuk zbatohet fare. Përtej një praktike jo të mirë këto lloj kërkesash janë të rregulluara me legjislacionin primar dhe sekondar prandaj një proces harmonizimi ligjor me LSSL dhe LPPA është i domosdoshëm.

Informatat të obligueshme të panevojshme dhe papërshtatshme, janë të vendosura në legjislacionin sekondar. Nëse analizohet Udhëzimi administrativ nr. 25/2017 Licencimi i Mësimdhënësve vërehet se për paisje me 6 licencat e parapara me këtë udhëzim, licenca këto që bien në fushëveprimtarinë e Departamentit për Arsim Parauniversitar, Divizioni për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, aplikuesi përpos dokumenteve të tjera duhet të dorëzojë këto dokumente: (i) Certifikatën e lindjes; (ii) Kopjen e letërnjoftimit; (iii) Vërtetimin e Punëdhënësit, (iv) Kontrata e punës, etj.. Të gjitha këto dokumente janë dokumente të cilat lëshohen nga ana e institucioneve publike për personin fizik, përpos 'Vërtetimit të Punëdhënësit', fakt ky që vërtetohet me Kontratën e Punës. Andaj, meqenëse Kontrata e Punës është dokument personal është rekomanduar që në vend të Kontratës së Punës të kërkohet vetëm Vërtetimi i Punëdhënësit. Këto kërkesa thjesht paraqesin kosto shtesë të panevojshme për aplikuesin. Gjithashtu, kjo paraqet një problem të madh dhe pengesë në realizimin e shpejtë dhe në mënyrë efikase për t'u pajisur me një licencë. Reduktimi i informatave të obligueshme si dhe thjeshtëzimi i tyre deri tek mundësia që të njëjtat të ofrohen nga vet organet publike është një nga kushtet kryesore për thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave në përgjithësi.

⁵ Tek Licenca për Licencimin e Institucioneve Private Aftesuese, aplikuesi është i obliguar që fillimisht të paguaje procedurën e aplikimit prej 500 euro dhe te njejten gjate procedures se rilicencimit, pra edhe njehere shumën prej 500 euro.

⁶ Ligji Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 86, paragrafi 1.

⁷ Ibid, paragrafi 3.

Pezullimi dhe revokimi, rregullohet me LSSL si veprime që mund t'i marrë organi kompetent për të verifikuar nëse ende plotësohen kushtet/kriteret ligjore për të cilat është dhënë leja. Në këtë aspekt LSSL përcakton një renditje të veprimeve që mund të ndërmerren siç është dhënja e një kohe të caktuar për korrigjimin/plotësimin e kushteve për të cilat është dhënë leja dhe nëse prap nuk plotësohen atëherë mund të vendoset një gjobë dhe nëse edhe pas gjobës nuk ndërmerren veprime për korrigjin e tyre atëherë leja mund të pezullohet dhe revokohet.

E drejta e ankesës, rregullohet në mënyrë të fragmentuar me legjislacionin primar dhe sekondar që përcakton lejimet përkatëse brenda fushëveprimtarisë së MASHTI. Gjatë analizës është vërejtur se në disa raste rregullat për lejimin e ankesës janë në kundërshtim me LSSL dhe LPPA ose mungojnë tërësisht, afatet në disa raste janë më të shkurtëra, adresimi i ankesës bëhet në kundërshtim me LPPA gjithashtu rregullat për organin epror dhe juridiksionin e tij nuk janë në pajtim me LPPA. Më konkretisht, tek licencimi i mësimdhënësve procedura e ankesës është paraparë në nenin 22 të Udhëzimit Administrativ Nr. 25/2017 për Licencimin e Mësimdhënësve i cili thotë që ankesat ndaj procesit të licencimit mund të bëhen në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës në MASHT, duke mos dhënë më shumë detaje.⁸ Njëkohësisht, tek Licencimi i Institucioneve Private Parashkollore është e përcaktuar se në rast të refuzimit të kërkesës për dhënien e licencës, pala ka të drejtë që MASHTI-t t'i bëjë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit për refuzimin e dhënies së licencës.⁹ Pos kësaj, askund nuk është e përcaktuar në asnjëën procedurë të licencave në kuadër të MASHTI afati brenda të cilës duhet të mirret vendimi ndaj ankesës së parashtruar nga ana e palës.

Te gjeturat kryesore

Gjatë analizës së lejimeve në kuadër të MASHTI, pa anashkaluar të gjeturat e veçanta për secilën lejim veç e veç, janë identifikuar këto të gjetura kryesore:

- Lloji i lejimit nuk është në pajtim me LSSL (në vend të lejes përdoret licenca dhe anasjelltas, si rasti me Licencën për Licencimin e Institucioneve Private Parauniversitare, Licencimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë privat, Licencimi i Institucioneve Parashkollore Private, të cilat në fakt duhet të jenë Leje);
- Të gjitha lejimet janë me afat të caktuar, pas kalimit të të cilit kërkohet rilicencimi dhe i njëjti nuk njihet nga LSSL;
- Pagesa dhe taksa administrative për secilin lejim janë në kundërshtim me LSSL dhe LPPA;
- Për t'u pajisur me një leje dhe licencë pala duhet t'i siguroj vet të gjitha dokumentet, faktet dhe informatat pavarësisht nëse të njëjtat janë në disponim të organeve publike. Nëse të njëjtat nuk ofrohen nga pala kërkesa refuzohet;
- Në përgjithësi ka kërkesa dhe informata të obligueshme të cilat janë të panevojshme por edhe të papërshtatshme të sigurohen;
- Nuk ekziston ndonjë PKV përmes së cilës do të mund të kryheshin të gjitha formalitetet nga aplikimi deri tek pajisja me një leje ose licencë;

⁸ Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhëzimit Administrativ Nr. 25/2017 për Licencimin e Mësimdhënësve, Neni 22.

⁹ Ministria e Arsimit, SHkencës dhe Teknologjisë. Udhëzim Administrativ Nr. 6/2011 Licencimi dhe regjistrimi I institucioneve educative-arsimore parashkollore private, Neni 19.

- Nuk ka rregulla të mjaftueshme për pezullimin ose revokimin e një lejimi ndërsa rregullat e parashikuara në LSSL nuk zbatohen;
- E drejta e ankesës është e rregulluar pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me LPPA.

Rekomandime të përgjithshme

Në këtë pjesë do të paraqiten rekomandimet e përgjithshme për lejimet në kuadër të MASHTI në bazë të analizave dhe të gjeturave më lartë:

- Të zvogëlohet numri i lejimeve dhe të njëjtat të vendosen në pajtim me LSSL bazuar në nivelin e rrezikut. Shembull konkret është rasti me: Licenca e përkohshme për mësimdhënës fillestar, Licenca për mësimdhënës merituar, Licenca për mësimdhënës të avancuar, Licenca për mësimdhënës të karrierës, Licenca për mësimdhënës të merituar dhe Licenca për bashkëpunëtor profesional ku realisht deri më tani është dhënë vetëm Licenca për mësimdhënës të karrierës. Asnjëra nga 5 licencat e tjera nuk është aplikuar. Propozimi konkret është që këto 6 licenca të riformulohen në gjithsej 3 licenca si në vijim: Licenca për mësimdhënës të karrierës, Licenca për mësimdhënës të avancuar dhe Licenca për mësimdhënës të përhershëm; Kjo ngaqë nuk ekziston nevoja e një licenceje të përkohshme si dhe licencave tjera. Sipas zyrtarëve të ministrisë, parashikimi i vetëm tre llojeve të licencave është i mjaftueshëm për rregullimin e këtij sistemi dhe i përgjigjen sistemit të edukimit dhe kriteve që duhet plotësuar nga ana e mësimdhënësve për pozitat e parapara në sistemin arsimor.
- Një tjetër problematikë qëndron me Licencimin e Institucioneve Private Arsimore, ku Udhëzimi Administrativ e parashihet licencimin e institucioneve private aftësuese dhe licencimin e institucioneve private profesionale. Por, në praktikë kur kemi të bëjmë me institucione profesionale/aftësuese që licencohen në kuadër të kësaj licence, si rastet kur kemi të bëjmë me kurse ose trajnime për floktari, etj., licencimi është i panevojshëm dhe i njëjti propozohet të hiqet.
- Lejet dhe licencat të jepen pa afat përderisa verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore mund të bëhet përmes inspektimit ose dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm që shërben si provë e mjaftueshme që të njëjtit vazhdojnë të plotësojnë kriteret e parapara ligjore;
- Pagesat dhe taksat administrative si rregull të mos zbatohet por edhe kur parashikohet me ligj e njëjta nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin organit publik për të administruar lejimin;
- Të zbatohet parimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare i përcaktuar në LPPA dhe dokumentet, faktet dhe informatat që janë në posedim të organeve publike të sigurohen nga vet organi publik kompetent për lejimin;
- Të themelohet së paku një PKV në kuadër të organeve të ministrisë i cili do të mundësonte kryerjen e të gjitha veprimeve për një lejim të caktuar;
- Pezullimi dhe revokimi i një licence të parashikohet me ligjet e veçanta ose të bëhet referencë në LSSL;
- Transferimi i lejes të mundësohet me ligjet e veçanta për të shmangur procesin e aplikimit dhe zhvillimit të procedurës në rast se një pjesë ose të gjitha të drejtat e shfrytëzimit barten tek një person tjetër përmes shitjes ose qirasë;
- E drejta e ankesës të rregullohet në pajtim me LPPA. të përcaktohet saktë organi epror që është kompetent për vendimmarrjen në lidhje me ankesat.

Të gjeturat dhe rekomandimet e veçanta

Pjesë e këtij raporti është edhe analiza që përfshinë secilin leje dhe licencë veç e veç, emrin dhe llojin e lejimit, autoritetin përgjegjës, të gjeturat, rekomandimet dhe justifikimin. Analiza e detajuar duke përfshirë të gjeturat dhe rekomandimet e veçanta është paraqitur në shtojcën nr.1.

Shtojca 1.

Ministria	Nr. ref	Emri lejimit	Lloji lejimit	Autoriteti pergjegjës	Te gjeturat	Rekomandimet	Justifikimi
				<i>Te ceket strukturata qe leshon lejimin.</i>	<i>Te ceken te gjeturat kryesore</i>	<i>Te ceken rekomandimet specifike .Spjego konkretisht nese lejimi duhet te shfuqizohet, bashkohet, ndryshohet lloji, thjeshtohet, zvoglohen/thjeshtohen informatat e obligueshme</i>	<i>Ofro justifikimi per secilin rekomandim</i>
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	DZHPM	<ol style="list-style-type: none"> Licenca e përkohshme për mësuesit fillestar Licenca për mësuesit mentor Licenca për mësuesit të avancuar Licenca për mësuesit të karrierës Licenca për mësuesit të merituar 	Licenca profesionale	MASHT I, Departamenti për Arsimit Parauniversitar, Divizioni i Zhvillimit Profesional të	<ol style="list-style-type: none"> Neni 32 dhe 33 I Ligji Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar Në Republikën E Kosovës parasheh licencimin e mësuesit. Neni 33.7 përcakton që “Rivlerësimi i një mësuesi të licencuar me qëllim të përtëritjes së licencës, do të ndodhë në një interval kohor që nuk kalon pesë vite nga data e lëshimit të licencës ekzistuese.” Poashtu, në UA përcaktohet që Licenca lëshohet për afat pesë (5) 	<ol style="list-style-type: none"> Të ndryshohet UA 25/2017 Licencimi i Mesimdhënësve, Ministria e Arsimit ashtuqë të mos parashihen gjashtë licenca të ndryshme por vetëm tri licenca (<i>Licenca për mësuesit të karrierës, Licenca për mësuesit të avancuar, Licenca për mësuesit të përhershëm</i>). Të ndryshohet UA 25/2017 Licencimi I Mesimdhënësve, Ministria e Arsimit ashtuqë të mos parashihet obligimi I pagesës së taksës. Të ndryshohet UA 25/2017 Licencimi I Mesimdhënësve, Ministria e Arsimit ashtuqë të mos kërkohet dorëzimi I këtyre dokumentave si në vijim: 	<ol style="list-style-type: none"> Në komunikim me zyrtarët e Ministrisë është kuptuar që e vetmja licencë e lëshuar deri më tani ka qenë Licenca për mësuesit të Karrierës. Asnjëra nga pesë licencat e tjera (<i>Licenca e përkohshme për mësuesit fillestar, Licenca për mësuesit mentor, Licenca për mësuesit të avancuar, Licenca për mësuesit të merituar, Licencimi I bashkëpunëtorëve profesional</i>) nuk është lëshuar ndonjëherë. Është propozuar të bëhet një rregullim i ri i cili do të përfshinte tri lloje licencash që do të bënte dallimin në kriteret e përvojës që duhet plotësuar, vlerësimin e

		<p>6. Licencimi I bashkëpunët orëve profesional</p>		<p>Mësimdhënësve</p>	<p>vjecar (UA 25/2017 Licencimi I Mesimdhënesve).</p> <p>3. UA 25/2017 Licencimi I Mesimdhënesve, Ministria e Arsimit parasheh 6 lloje të licencave. Nga gjashtë (6) licencat e parapara me UA 25/2017, Ministria e Arsimit e lëshon vetem Licencën e karrierës. Pesë (5) licencat tjera nuk lëshohen.</p> <p>4. Neni 18.5 I UA 25/2017 Licencimi i Mesimdhënesve parasheh pagesën prej 10 euro për secilën licencë.</p> <p>5. Dokumentet që kërkohet të dorëzohen me rastin e marrjes së licencës së mësimdhënësit të karrierës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formulari - Kontrata e Punes - Vertetimi I Punedhënësit - Diploma e noterizuar - Llojet e trajnimeve - Certifikata e lindjes - Kopja e leternjoftimit 	<ul style="list-style-type: none"> - Certifikata e lindjes - Kopja e leternjoftimit - Vertetimi I Punedhënësit <p>4 . Të përcaktohet procedura e ankesës sipas LPPA.</p> <p>5. Rilicencimi si proces nuk duhet aplikohet. Licencat e mësimdhënësve duhet të jene objekt i pezullimit dhe heqjes se licencës në rast se të njejtat nuk plotësojnë kushtet e licencimit. Afati i licencave të propozuara të jetë si në vijim: <i>Licenca për mësimdhënës të karrierës (7 vite), Licenca për mësimdhënës të avancuar (8 vite), Licenca për mësimdhënës të përhershëm.</i></p>	<p>përformancës si dhe pagën që paguhën mësimdhënësit. Për më tepër, Licenca për bashkëpunëtor profesional si dhe Licenca e përkohshme për mësimdhënës fillestar është konsideruar të jetë e panevojshme edhe nga vetë zyrtarët.</p> <p>2. PAGESA E CILA PARASHIHET ME</p> <p style="padding-left: 40px;">UA 25/2017 nuk është aplikuar asnjëherë, andaj edhe konsiderohet të jetë e panevojshme.</p> <p>3. Heqja e dokumenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Certifikata e lindjes - Kopja e leternjoftimit - Vertetimi I Punedhënësit <p>Kjo bëhet për arsyet të mos ekzistimit të nevojës që kandidatët të dorëzojnë këto dokumente të lëshuara nga institucione tjera shtetërore. Dorëzimi I të njejtës krijon barrë të madhe administrative për kandidatët dhe është tërësisht i pakuptimtë.</p> <p>4. LPPA është ligj kornizë I cili parasheh parimet që duhet ndjekur në cdo procedure administrative.</p>
--	--	---	--	----------------------	--	---	---

					<p>3.Neni 29 I Udhëzim Administrativ Nr. 06/2011 Licencimi dhe Regjistrimi I Institucioneve Edukative-Arsimore Parashkollore parasheh taksen prej 100 euro e cila duhet paguar me rastin e licencimit dhe ri-licencimit.</p>	<p>5. Rekomandohet që afati i vlefshmërisë së licencës së parë të jetë 3 vite, ndërsa afati i rilicencimit të jetë 5 vite.</p>	<p>3.Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë leje nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar këtë procedurë (neni 18 i Ligjit për Sistemimin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim i tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë kësaj procedure.</p> <p>4.LPPA është ligj kornizë I cili parasheh parimet që duhet ndjekur në cdo procedure administrative, përfshirë procedurën e ankesës.</p> <p>5.Rilicencimi nuk njihet si term në LSSL dhe i njejtë nuk është ligjor. Institucionet duhet te jene objekt i pezullimit dhe heqjes se licencës në rast se të njejtat nuk fitojnë akreditimin dhe nuk plotësojnë kushtet e licencimit. Mirëpo për shkak të kushteve në praktikë dhe mungësës së kapaciteteve inspektuese, është paraparë zgjatja e afateve të licencës.</p>
Ministria e Arsimit	DA PP	Licenca e institucioneve private	Leje	MASHT I, Departament	1. Neni 46 I Ligjit Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar Në Republikën E Kosovës parasheh	1. Të ndryshohet UA 17/2016 ashtuqë të: <ul style="list-style-type: none"> - Emërtoj Licencën e Institucioneve Private si Leje për Institucionet 	1. Ndryshimi i emërimit bëhet me qëllim të harmonizimit të këtij lejimi me përkufizimet e parapara në Ligjin për

mit, Shkencës, Teknologji së dhe Inovacionit	2-A	parauniversitare		mentit për Arsim Parauniversitar, Divizioni i për Arsimin e Lartë Parauniversitar	<p>licencimin e institucioneve private parauniversitare.</p> <p>2. UA 17/2016 parasheh kushtet dhe kriteret për licencimin e institucioneve private arsimore dhe aftesuese profesionale parauniversitare.</p> <p>3. Dokumentet që kërkohen me rastin e aplikimit për licencë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formulari, - Certifikata e regjistrimit të biznesit, - Akti I themelimit të IPAAPP, - Struktura organizative e IPAAPP, - Rregullorja e punes, - Kodi I miresjelljes, - Dëshmia për pronësinë ose marrjen me qera të objektit, - Dëshmi për lejen e ndërtimit ose procesin e legalizimit për objektin në pajtushmëri me kërkesën, 	<p>Private meqë kemi të bëjme me lejim për persona juridik dhe jo për persona fizik.</p> <p>2.Të mos kërkohet dorëzimi idokumenteve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Certifikata e regjistrimit të biznesit, - Dëshmi për lejen e ndërtimit ose procesin e legalizimit për objektin në pajtushmëri me kërkesën - Vertetimi për plotesimin e kushteve për siguri nga zjarri <p>3.Taksa e cila aplikohet për paisjen e kësaj licence të llogaritet në kuadër të kostos së saj, ashtuqë e njëjta të jetë në perputhje me nenin 18 të ligjit për leje licenca. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti.</p> <p>4.Procedura e ankesës të parashihet si në LPPA.</p>	<p>Sistemimin e Lejeve dhe Licencave për Licencat Profesionale (neni 9) dhe Lejet (neni 8). Ndërkaq, ky lloj lejimi bie nën kufizimin e paraparë me Leje dhe si I tille duhet emëruar si Leje për Institucionet Private Arsimore.</p> <p>2.Heqja e dokumenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Certifikata e regjistrimit të biznesit, - Dëshmi për lejen e ndërtimit ose procesin e legalizimit për objektin në pajtushmëri me kërkesën - Vertetimi për plotesimin e kushteve për siguri nga zjarri <p>Kjo behet për arsyet të mos ekzistimit të nevojës që kandidatët të dorëzojnë këto dokumente të lëshuara nga institucione tjera shtetërore. Dorëzimi I të njëjtës krijon barrë të madhe administrative për kandidatët dhe është tërësisht I pakuptimtë.</p> <p>3. Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë leje nuk duhet të kalojë shumë e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar këtë procedurë (neni 18 i Ligjit për Sistemimin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim i tillë mund të</p>
--	-----	------------------	--	---	--	--	---

					<ul style="list-style-type: none"> - Projektdizajni, - Statuti I IPAAPP, - Plani I biznesit, - Vertetimi nga gjykata që themeluesi apo personi I autorizuar nuk është nën hetime, - Vertetimi për plotësimin e kushteve sanitarike, - Vertetimi për plotësimin e kushteve për siguri nga zjarri, - Lista e kuadrit edukativë arsimor - Plani zhvillimor I institucionit arsimor - Plani dhe programi vjetor I punës, - Programet lealore sipas klasave, drejtimeve dhe profileve arsimore të aprovuara nga MASHT apo të akredituara nga AKK, 	<p>kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë kësaj procedure.</p> <p>4. LPPA është ligj kornizë i cili parasheh parimet që duhet ndjekur në çdo procedure administrative.</p>
--	--	--	--	--	--	---

				<p>- Kopja e kontrates ne mes te IPAAPP, kandidatit, nxenesit, prindit per regjistrim,</p> <p>- Marreveshje me ndonje institucion edukativo arsimor te fushes se perafert qe sherben si garancion per vazhdimin e vijueshmerise se procesit edukativo mesimor ne rast te nderprerjes se veprimtarise,</p> <p>- Garancia bankare.</p> <p>4. Validiteti i licencës së shkollave fillore është 5 vite, me 5 vite vazhdim, I shkollës së mesme të ulët është 4 vite, me 4 vite vazhdim, I shkollës së mesme të lartë është 3 vite, em 3 vite vazhdim. Licencimi i pare jepet ne kohezgjatje prej nje cikli arsimor sipas niveleve (niveli fillor - 5 vite; i mesem i ulet - 4 vite; i mesem i larte - 3 vite), ndersa rilicencimi zgjat per dy cikle arsimore.</p> <p>5. Pagesa e paraparë për licencim është shuma 500 euro.</p>	
--	--	--	--	---	--

<p>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</p>	<p>DA PP 3- A</p>	<p>Licenca e institucioneve private aftësuese</p>	<p>Leje</p>	<p>MASHT I, Departamentit për Arsim Parauniversitar, Divizion i për Arsimin e Lartë Parauniversitar</p>	<p>11. Neni 46 i Ligjit Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar Në Republikën E Kosovës parasheh licencimin e institucioneve private parauniversitare.</p> <p>2. UA 17/2016 parasheh kushtet dhe kriteret per licencimin e institucioneve private arsimore dhe aftesuese profesionale parauniversitare. Në këtë rast kemi të bëjmë me dy licenca në praktikë. Meqenese te gjitha kushtet, dokumentacioni, dhe tarifat per licencim te institucioneve private aftesuese dhe profesionale jane te njejta, nuk bëhet ndonjë ndarje ne mes tyre dhe mbesin në një vend ashtu sic parashihen me UA. Mirëpo, në praktikë kemi të bëjmë me institucione profesionale/aftësuese që licencohen në kuadër të kësaj licence, të cilat ofrojnë kurse ose trajnime për floktari, etj. Pra, në nënin 3 parasheh kushtet dhe</p>	<p>1. Të ndryshohet UA 17/2016 ashtuqë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtoj Licencën e Institucioneve Private si “Leje për Institucionet Private Aftësuese” meqë kemi të bëjme me lejim për persona juridik dhe jo për persona fizik. <p>2. Të mos kërkohet dorëzimi i dokumenteve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Certifikata e regjistrimit të biznesit, - Struktura organizative e IPAAPP, - Rregullorja e punes, - Dëshmia për pronësinë ose - Vertetimi per plotesimin e kushteve per siguri nga zjarri - Lista e kuadrit edukative arsimor - Plani zhvillimor I institucionit arsimor - - Plani dhe programi vjetor I punes, - - Programet lendore sipas klasave, drejtimeve dhe profileve arsimore te aprovuara nga MASHT apo te akredituara nga AKK, - Garancia bankare. 	<p>1. Ndryshimi i emërimit bëhet me qëllim të harmonizimit të këtij lejimi me përkufizimet e parapara në Ligjin për Sistemimin e Lejeve dhe Licencave për Licencat Profesionale (neni 9) dhe Lejet (neni 8). Ndërkaq, ky lloj lejimi bie nën kufizimin e paraparë me Leje dhe si I tille duhet emëruar si Leje për Institucionet private aftësuese.</p> <p>Të ndryshohet praktika e kërkesës për licencim të institucioneve aftësuese të cilat janë vetëm kurse, si kurset e floktarisë.</p> <p>2. Heqja e dokumenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Certifikata e regjistrimit të biznesit, - Struktura organizative e IPAAPP, - Rregullorja e punes, - Vertetimi per plotesimin e kushteve per siguri nga zjarri - Lista e kuadrit edukative arsimor - Plani zhvillimor I institucionit arsimor - - Plani dhe programi vjetor I punes, - - Programet lendore sipas klasave, drejtimeve dhe profileve arsimore
--	-------------------------------	---	-------------	---	--	--	--

				<p>kriteret e IPAAPP për tu licencuar. IPAAPP në përkufizim përfshin institucionet profesionale që kërkojnë akreditim dhe ato që nuk kërkojnë akreditim.</p> <p>5.. Dokumentet që kërkohen me rastin e aplikimit për licencë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formulari, - Certifikata e regjistrimit të biznesit, - Akti I themelimit të IPAAPP, - Struktura organizative e IPAAPP, - Rregullorja e punes, - Kodi I miresjelljes, - Dëshmia për pronësinë ose marrjen me qera të objektit, - Dëshmi për lejen e ndërtimit ose procesin e legalizimit për objektin në pajtushmëri me kërkesën, - Projektdizajni, - Statuti I IPAAPP, - Plani I biznesit, - Vertetimi nga gjykata që themeluesi apo personi I autorizuar nuk është nën hetime, 	<p>3.Taksa e cila aplikohet për paisjen më këtë leje të llogaritet në kuadër të kostos së saj, ashtuqë e njejta të jetë në perputhje me nenin 18 te ligjit per leje licenca. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti.</p> <p>4.Procedura e ankesës të parashihet si në LPPA</p>	<p>te aprovuara nga MASHT apo te akredituara nga AKK,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Garancia bankare. <p>Kjo behet për arsyet të mos ekzistimit të nevojës që kandidatët të dorëzojnë këto dokumente të lëshuara nga institucione tjera shtetërore si dhe njëkohësisht, shumica nga ato kërkohen me rastin e akreditimit. Dorëzimi I të njejtës krijon barrë të madhe administrative për kandidatët dhe është tërësisht I pakuptimt.</p> <p>3.Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë leje nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar këtë procedurë (neni 18 i Ligjit për Sistemimin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim i tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë kësaj procedure.</p> <p>4.LPPA është ligj kornizë i cili parasheh parimet që duhet ndjekur në cdo procedure administrative.</p>
--	--	--	--	---	--	---

				<ul style="list-style-type: none"> - Vertetimi per plotesimin e kushteve sanitarike, - Vertetimi per plotesimin e kushteve per siguri nga zjarri, - Lista e kuadrit edukative arsimor - Plani zhvillimor I institucionit arsimor - Plani dhe programi vjetor I punes, - Programet lendore sipas klasave, drejtimeve dhe profileve arsimore te aprovuara nga MASHT apo te akredituara nga AKK, - Kopja e kontrates ne mes te IPAAPP, kandidatit, nxenesit, prindit per regjistrim, - Marreveshje me ndonje institucion edukativo arsimor te fushes se perafert qe sherben si garancion per vazhdimin e vijueshmerise se procesit edukativo mesimor ne rast te nderprerjes se veprimtarise, - Garancia bankare. <p>6. Validiteti i licencës së shkollave fillore është 5 vite, me 5 vite vazhdim, I shkollës së</p>	
--	--	--	--	--	--

					<p>mesme të ulët është 4 vite, me 4 vite vazhdim, I shkollës së mesme të lartë është 3 vite, em 3 vite vazhdim. Licencimi i pare jepet ne kohezgjatje prej nje cikli arsimor sipas niveleve (niveli fillor - 5 vite; i mesem i ulet - 4 vite; i mesem i larte - 3 vite), ndersa rilicencimi zgjat per dy cikle arsimore</p> <p>7. Pagesa e paraparë për licencim është shuma 500 euro.</p>		
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	DA L1-A	Licenca e bartësve privat të arsimit të lartë	Leje	MASHT I, Departamentit për Arsimin e Lartë	<p>1. Neni 9.4 11.3, 12.3, 14 i Ligjit Nr. 04/L-037 Për Arsimin E Lartë Në Republikën E Kosovës parasheh licencën për institucionet e arsimit të lartë privat.</p> <p>2. Neni 14 I Ligjit përcakton se Licenca ka validitet 5 vjecar, aq sa ka edhe akreditim. Neni 6 I UA 25/2012 e parasheh të njëjtën.</p> <p>3. Disa nga dokumentet te cilat kërkohen me rastin e dorëzimit janë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa për licencim, - Vendimi mbi themelim, 	<p>1. Licencimi i institucioneve të arsimit të lartë privat duhet emërtuar si Leje për institucionet e arsimit të lartë privat meqë kemi të bëjme me lejim për persona juridik dhe jo për persona fizik.</p> <p>2. Të ndryshohet UA 25/2012 dhe të mos kërkohen dokumentet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa për licencim, - Struktura organizative (organogrami) - Certifikata e regjistrimit, - Vertetimi mbi plotesimin e kushteve per siguri nga zjarri - Lokale te mjaftueshme te paisura sipas standardeve - Biblioteka me inventar dhe me fond te pasur librash, - Kabinete me paisje kompjuterike, 	<p>1. Ndryshimi i emërimit bëhet me qëllim të harmonizimit të këtij lejimi me përkufizimet e parapara në Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave për Licencat Profesionale (neni 9) dhe Lejet (neni 8). Ndërkaq, ky lloj lejimi bie nën kufizimin e paraparë me Leje dhe si I tille duhet emëruar si Leje për Institucionet e arsimit të lartë privat.</p> <p>2. Heqja e dokumenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa për licencim, - Struktura organizative (organogrami) - Certifikata e regjistrimit, - Vertetimi mbi plotesimin e kushteve per siguri nga zjarri

				<ul style="list-style-type: none"> - Emërtimi dhe selia, - Struktura organizative (organogrami), - Historiku I shkurter, - Certifikata e regjistrimit, - Dëshmia per pronesine ose marrjen me qerate lokaleve per kohen e licencimit, - Vërtetimi mbi plotësimin e kushteve per siguri nga zjarri, - Statuti per qeverisje, - Rregullorja e punes, - Kodi I miresjelljes, - Vërtetimi se kunder themeluesit nuk eshte hapur ndonje procedure ligjore, - Lokale te mjaftueshme te paisura sipas standardeve, - Leja e ndertimit per ato që zhvillojne veprimtari arsimore, kërkimore shkencore, - Biblioteka me inventar dhe me fond te pasur librash, - Kabinete me paisje kompjuterike, - Lista e punetoreve (kopjet e diplomave te vertetuara) - Lista e kuadrit administrative 	<ul style="list-style-type: none"> - Lista e punetoreve (kopjet e diplomave te vertetuara) - Lista e kuadrit administrative - Plani dhe programi vjetor I punes - Kopja e kontrates ne mes te institucionit dhe personelit - Garancioni bankar per Shumen e te hyrave - Leja e ndertimit per ato që zhvillojne veprimtari arsimore, kërkimore shkencore - Taksa e cila aplikohet për paisjen e kësaj licence të llogaritet në kuadër të kostos së saj, ashtuqë e njejtë të jetë në perputhje me nenin 18 te ligjit per leje licenca. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti. <p>4.Procedura e ankesës të parashihet si në LPPA.</p> <p>5. Rekomandohet që afati i vlefshmërisë së licencës të zgjatet në 6 vite.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Lokale te mjaftueshme te paisura sipas standardeve - Biblioteka me inventar dhe me fond te pasur librash, - Kabinete me paisje kompjuterike, - Lista e punetoreve (kopjet e diplomave te vertetuara) - Lista e kuadrit administrative - Plani dhe programi vjetor I punes - Kopja e kontrates ne mes te institucionit dhe personelit - Garancioni bankar per Shumen e te hyrave - Leja e ndertimit per ato që zhvillojne veprimtari arsimore, kërkimore shkencore behet për arsyet të mos ekzistimit të nevojës që kandidatët të dorëzojnë këto dokumente të lëshuara nga institucione tjera shtetërore. Për më tepër, dokumentet si: 1)Struktura organizative; 2) Dëshmia për pronësinë ose marrjen me qera të lokaleve; 3) Vërtetimi mbi plotësimin e kushteve për siguri nga zjarri; 4) Rregullorja e punës; 5) Lokalet e mjaftueshme të paisura sipas standardeve; 6) Biblioteka me inventar dhe me fond te pasur librash; 7) Kabinete me paisje kompjuterike; 8) Listat e punetoreve; 9) Listat e kuadrit administrativ; 10) Plani dhe programi vjetor i punës; 11)
--	--	--	--	---	---	--

				<ul style="list-style-type: none"> - Plani dhe programi vjetor I punes - Emertimi I dokumenteve qe do ju leshojne studenteve - Kopja e kontrates ne mes te institucionit dhe personelit - Garancioni bankar per Shumen e te hyrave - Plani I biznesit per kohezgjatjen e licences - Shuma e caktuar e pageses qe student eshte I obliguar te paguaj per nje vit akademik. <p>4. Taksa e cila paguhet me rastin e licencimit percaktohet me vendim nga ana e Ministrit. E njejta nuk aplikohet.</p> <p>5. Në rast të refuzimit të kërkesës për dhënien e licencës, pala së cilës i është refuzuar kërkesa, ka të drejtë që MASHT-it t'i bëjë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit për refuzimin e dhënies së licencës.</p>	<p>Kopja e kontratës në mes të institucioneve dhe personelit; 12) Garancioni bankar, janë dokumente që kërkohen me rastin e akreditimit. Dhe dorëzimi I të njejtave dy herë krijon barrë të madhe administrative për kandidatët dhe është tërësisht I pakuptimt.</p> <p>3. Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë leje nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar këtë procedurë (neni 18 i Ligjit për Sistemimin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim i tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë kësaj procedure.</p> <p>4. LPPA është ligj kornizë I cili parasheh parimet që duhet ndjekur në cdo procedure administrative.</p> <p>5. Rilicencimi nuk njihet si term në LSSL dhe i njejti nuk është ligjor. Institucionet duhet te jene objekt i pezullimit dhe heqjes se licencës në rast se të njejtat nuk fitojnë akreditimin dhe nuk plotësojnë kushtet e licencimit.</p>
--	--	--	--	--	---

							Mirëpo për shkak të kushteve në praktikë dhe mungësës së kapaciteteve inspektuese, është paraparë zgjatja e afateve të licencës.
--	--	--	--	--	--	--	--